



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 16 tetor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Mbrojtjes së Krasniqit për pranim të 39 provave materiale shtesë dhe shtim të dy materialeve në listën e provave materiale të saj. Trupi Gjykses miratoi pranimin e 30 provave materiale dhe pranimin pjesërisht të një prove materiale shtesë, pasi i konstatoi ato relevante për çështjen, autentike në pamje të parë dhe, duke marrë parasysh që palët mund të bëjnë parashtrime lidhur me peshën dhe vlerën provuese të tyre, konsideroi se ato nuk zhbëheshin nga ndonjë efekt dëmtues. Trupi Gjykses miratoi gjithashtu shtimin e dy materialeve në listën e provave materiale.

Trupi Gjykses refuzoi pranimin në prova të 8 materialeve dhe pjesërisht të një materiali pasi i konstatoi ato jorelevante për çështjen, për shkak se ato ose nuk lidhen me asnjë nga akuzat e paraqitura në aktakuzë, ose lidhen me një veprimtari të UÇK-së në një vend jorelevant për akuzat, ose përmbajnë prova të krimeve të kryera nga forcat serbe, të cilat po ashtu nuk janë pjesë e aktakuzës dhe, për rrjedhojë, nuk janë relevante për akuzat.

Më 16 tetor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë për konstatim gjyqësor të 68 fakteve të shqyrtuara në çështjen kundër Pjetër Shalës. Trupi Gjykses bëri konstatim gjyqësor të 66 prej këtyre fakteve, pasi konstatoi se ato përmbushin kriteret përkatëse për faktet e shqyrtuara në procese të tjera, siç përcaktohet në Rregulloren e Procedurës dhe Provave. Trupi Gjykses nuk pranoi dy fakte.

Mbrojtja kundërshtoi pjesën dërmuese të fakteve duke argumentuar se, në këtë fazë të procesit, mundësia e saj për të kundërshtuar saktësinë e fakteve të propozuara është e kufizuar dhe, rrjedhimisht, kjo do të komprometonte detyrat e Trupit Gjykses për zbulimin e së vërtetës. Megjithatë, Trupi Gjykses vuri në dukje se ai nuk ishte informuar se ndonjëri nga ekipet e Mbrojtjes dëshironte të paraqiste kundërprova ndaj cilitdo prej fakteve në fjalë, duke shtuar se, nëse ndonjëri nga ekipet e Mbrojtjes dëshironte ta bënte këtë, Trupi Gjykses do ta shqyrtonte një kërkesë të tillë. Për shkak se faktet në fjalë janë kryesisht të llojit konfirmues, Trupi Gjykses konstatoi se të gjitha ekipet e Mbrojtjes kanë pasur dhe ende kanë mundësinë të kundërshtojnë saktësinë e tyre dhe të kërkojnë të paraqesin kundërprova ndaj secilit prej fakteve të propozuara.

Seanca që fillimisht ishte planifikuar për javën tjetër në këtë çështje gjyqësore është anuluar për arsye logjistike. Seanca e radhës është planifikuar për të hënë, 3 nëntor, në orën 9 të mëngjesit.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në lidhje me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 17 tetor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake





miratoi një kërkesë të Prokurorisë për të nxjerrë për Mbrojtjen prova shtesë të marra pas përfundimit të afatit për nxjerrjen e atij materiali. Sipas Prokurorisë, materiali në fjalë përfshinte të dhëna të marra nga pajisje elektronike të nxjerra më parë dhe të dhëna plotësuese që hedhin më shumë dritë mbi materialet e nxjerra më parë.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se materialet shtesë japin informacion plotësues dhe kontekstual të rëndësishëm, që do të përmirësojë të kuptuarit e përgjithshëm dhe vlerësimin e provave të paraqitura nga Prokuroria. Ajo gjithashtu mbajti parasysh se ato ishin identifikuar për nxjerrje sipas rregullës 102 vetëm në kontekstin e përgatitjes së dosjes paraprake të Prokurorisë dhe rikujtoi se çështja është në procedurë paraprake, gjatë së cilës duhet të ruhet një nivel i caktuar fleksibiliteti.

Duke mbajtur parasysh të drejtat e të akuzuarve dhe që Mbrojtja të ketë kohë të mjaftueshme për të përgatitur paraqitjen e provave të saj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vuri në dukje se Mbrojtja tashmë është njohur me pjesën më të madhe të materialeve shtesë dhe se ato nuk paraqesin ndonjë aspekt të ri në provat e Prokurorisë. Ajo gjithashtu konstatoi se kuadri, vëllimi dhe kompleksiteti i materialeve është i kufizuar dhe arriti në përfundimin se lejimi i nxjerrjes së tyre nuk i dëmton të akuzuarit.

Gjithashtu, më 17 tetor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes së Kilajt për zgjatje të afatit për dorëzimin e dosjes paraprake të saj bazuar në njoftimin e Prokurorisë se ajo do të nxjerrë së shpejti material që mund të gjejë në telefonin e sekuestruar të z. Kilaj, pasi ai të jetë analizuar në aspektin kriminalistik. Mbrojtja e Thaçit dhe e Kuçit iu bashkuan kësaj kërkesë.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se argumenti i z. Kilaj se provat e Prokurorisë në mbështetje të akuzave të saj mund të ndryshojnë pas shqyrtimit të materialit që gjendet në telefon është i gabuar dhe theksoi se, në këtë fazë të procesit, çdo provë shtesë mund të konsiderohet vetëm si plotësuese pa ndryshuar përmbajtjen dhe natyrën e akuzave të paraqitura në aktakuzë. Gjykatësja e Procedurës Parake konstatoi se argumenti i z. Kilaj se Prokuroria mund të parashtrojë një shtesë të dosjes paraprake aktuale të saj është hamendësues dhe i parakohshëm në këtë fazë dhe i garantoi palët se, nëse do të ndodhë kjo, ajo do të marrë masat e nevojshme për të garantuar drejtësinë e procesit dhe të drejtat e të akuzuarve.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujtoi se Mbrojtja nuk ka asnjë detyrim të dorëzojë dosje paraprake dhe konstatoi se Mbrojtja nuk paraqiti arsye të vlefshme për shtyrjen e afatit. Për rrjedhojë, ajo i ftoi ekipet Mbrojtjes përsëri që t'i dorëzonin dosjet paraprake të tyre, nëse dëshironin, deri më 20 tetor 2025.

Më 16 tetor, Gjykata Supreme lëshoi një vendim mbi afatet në lidhje me kërkesën e Pjetër Shalës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe urdhëroi Prokurorinë dhe Mbrojtësin e Viktimave të dorëzojnë përgjigjet përkatëse të tyre ndaj kërkesës deri më 3 dhjetor 2025, dhe z. Shala të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij ndaj përgjigjeve, nëse ka, deri të premten, 16 janar 2026.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
Nr. 39/2025
Hagë, 23/10/2025

Në lajme të tjera, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara ishte në Kosovë këtë javë për t'u shpjeguar mandatin dhe proceset gjyqësore në gjykatë grupeve të interesuara dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve. Ekipi u takua me studentë të drejtësisë në Gjilan dhe Pejë dhe me një komunitet lokal në Janjevë.

